



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI PORTUAL Durrës

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “F/V spreader Eh170U dhe aktivizimi i spreader ”, (*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mall*)- *Marrëveshje Kuadër*

VLERA E FONDIT LIMIT: 8.000.000 (Tetë milion) lekë, pa TVSH,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Afati i lëvrimit do jetë **12 (dymbëdhjetë) muaj** nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër.

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (sipas shtojcës 8).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së i ndryshuar, nenin 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të realizuar për tre viteve e fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit Udhëzim i Përgjithshëm. nr. 26, datë 8.9.2023 për tatimin mbi të ardhurat, Ligj nr. 29/2023 për tatimin mbi të ardhurat. Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % e vlerës së përllëgaritur të fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen **vërtetime** të lëshuara nga një ent publik ose **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore** të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të furnizimet e realizuara. Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e

VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Ofertë Teknike

Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për mallrat e listes në formatin e **Ofertes Teknike**, në formën e një tablele sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

- Emri i kompanisë prodhuese
- Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike
- Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli
- Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara. Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.3 Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qarte materialet që do të ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qarte që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

Argumentim: Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e shërbimit të paktën 1 (një) punonjës specialist të certifikuar në programim PLC (Programmable Logic Controller). Specialisti duhet të jetë pjesë e stafit të operatorit ekonomik ose i angazhuar me kontratë bashkëpunimi për realizimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Certifikaten përkatëse në programim PLC;
- Dokumentacion që provon disponueshmërinë e specialistit për realizimin e kontratës (kontratë pune dhe listepagesat e 3 (tre) muajve të fundit, në rastin kur specialisti është pjesë e stafit të operatorit ekonomik, ose kontratë bashkëpunimi/ deklaratë angazhimi, në rastin kur specialisti është ekspert i angazhuar nga jashtë për realizimin e kontratës.)

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme si dhe staf të kualifikuar dhe të profilizuar/certifikuar sipas natyrës së zërave dhe tipologjisë së ndërhyrjeve objekt procedure për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

Argumentimi i marrëveshjes kuadër:

1. Marrëveshja kuader do të lidhet me një operator ekonomik pasi janë të përcaktuara të gjitha kushtet kryesore të zbatimit të saj të tilla si: artikujt objekt prokurimi, specifikimet e sakta teknike, standardet e kërkuara, si dhe sasitë që priten të furnizohen gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes.
2. Nga përvoja e prokurimeve të artikujve të ngjashme me artikujt e kësaj procedure në vitet e mëparshme, është konstatuar se çmimet e tregut kanë qenë relativisht të qëndrueshme dhe pa luhatje të ndjeshme, duke reflektuar stabilitet në tregun përkatës të këtyre produkteve.
3. Lidhja e marrëveshjes kuadër me disa operatorë ekonomikë do të krijonte kosto shtesë dhe vështirësi në koordinimin e furnizimeve, rritje të riskut për mospërputhje të artikujve si dhe kompleksitet në administrimin e kontratës, përfshirë shpërndarjen e kërkesave për materiale, kontrollin e cilësisë dhe unifikimin e produkteve të furnizuara.
4. Marrëveshja kuadër përcaktohet duke pasur parasysh nevojën për fleksibilitet në realizimin e porositve sipas nevojave faktike të Autoritetit Kontraktor. Ky instrument siguron vazhdimësi të furnizimit, unifikim të produkteve dhe administrim më efikas të kontratës gjatë gjithë periudhës së zbatimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Garancia e mallrave dhe shërbimeve të ofruara:

Operatori ekonomik duhet të japë garanci për mallrat/pjesët e furnizuara dhe shërbimet e kryera për një periudhë jo më pak se **12 (dymbëdhjete) muaj** nga data e marrjes në dorëzim të tyre.

Gjatë periudhës së garancisë, operatori ekonomik është i detyruar të zëvendësojë pa kosto çdo pjesë me defekt dhe të korrigjojë çdo problem që lidhet me shërbimin e kryer, brenda një afati të arsyeshëm nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor.

KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.

A. Në fazen e pranimit, janë të detyruar të paraqesin;

1. **Dokumente origjinale** ose te njevlëshme, te deklaruar ne institucionet tona zyrtare, me ane te te cilave te demonstrohen produktet e ofruara.
2. **Dokumenta qe vertetojne Origjinën e Produkteve** te furnizuara

VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA

AUTORITETI KONTRATOR, rezervon te drejten të kryeje, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, per tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve te kerkuara.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat reale të Autoritetit Kontraktor për mallrat objekt të kësaj procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme si dhe karakteristikat teknike të pajisjeve ekzistuese (Spreader,Vinca Mobile), për të cilat këto materiale do të përdoren.

Për hartimin e tyre janë marrë në konsideratë standardet kombëtare dhe ndërkombëtare , duke synuar garantimin e përputhshmërisë teknike, funksionimit normal dhe jetëgjatësisë së pajisjeve.

Specifikimet teknike paraqiten me referenca të sakta teknike në dokumentin “Lista e Materialeve”, ku përbri çdo zëri të listës janë pasqyruar kodet e secilës pjesë të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, sipas kolonës së emërtuar ‘Kodi i Pjesës’, për të gjithë listën e mallrave objekt prokurimi, si dhe me paraqitjen e katalogëve përkatës sipas kodeve dhe klasifikimeve të prodhuesve të këtyre pajisjeve, me qëllim sigurimin e produkteve ekuivalente ose të përputhshme me ato të rekomanduara nga prodhuesit e pajisjeve.

Ky përcaktim është në përputhje me nenin 4, pika 38/b dhe nenin 36 të Ligjit për Prokurimin Publik, i ndryshuar, si dhe nenin 40, pika 1 dhe 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, duke respektuar parimet e mosdiskriminimit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo

prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
PERLLOGARITJES SE VLERES SE FONDIT LIMIT